VENDIM
Nr. 696, datë 22.10.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "URA E MATIT, BURREL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Ura e Matit, Burrel".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë arë, truall dhe objekte, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 2 084 835 (dy milionë e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 2 084 835 (dy milionë e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014 (zëri shpronësimet), planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 140 500 (njëqind e dyzet mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Sektori i shpronësimeve

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË OBJEKTIN "NDËRTIM URA E MATIT, BURREL"

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastral	Numri i pasurisë	Sipërfaqe totale	TOKË ARË			TOKË TRUALL			Objekte		Vlera totale (lekë)	Shënime
							Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë		
	FSHATI FSHAT-BURREL Z.K. 1325															
1	Islam	Rrahman	Hysa	1325	479	5200				670	150	100500	Ndërtesë	1,840,515	1,941,015	Konfirmim ZVRPP
	FSHATI ZALL-SHOSHAJ Z.K. 3882															
2	Zylyftar	Ismail	Lezaj	3882	466/17	500	163	153	24939						24939	Konfirmim ZVRPP
3	Zylyftar	Ismail	Lezaj	3882	466/18	2430	657	153	100521						100521	Konfirmim ZVRPP
4	Kapllan	Ramadan	Lezaj	3882	466/14	1200	120	153	18360						18360	Konfirmim ZVRPP
		SHUMA					**940**		**143820**	**670**		**100500**		**1840515**	**2,084,835**	